



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2276/5 prot.

Pogradec, më 21.05, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Znj. MANJOLA KAMOLLI KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur, po ju dërgojmë projekt vendimin, relacionin dhe dokumentacionin shoqërues, për:

“Për miratimin e vendodhjes së terminalit të transportit publik për Bashkinë Pogradec, miratimin e tarifave dhe rregullores së funksionimit”.

Me respekt,



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: _____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i faqeve A3 të relacioni shoqërues: _____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot

Pogradec, më _____, _____, 2024

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË _____, _____, 2024

**“PËR
MIRATIMIN E VENDNDODHJES SË TERMINALIT TË TRANSPORTIT
PUBLIK PËR BASHKINË POGRADEC, MIRATIMIN E TARIFAVE DHE
RREGULLORES SË FUNKSIONIMIT”.**

Në mbështetje të nenit 23, pika 6, nenit 54, gërma k, e ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore” të ndryshuar, nenit 21/1, ligjit nr. 8308, datë 18/03/1998 “Për transportin Publik”, i ndryshuar dhe udhëzimin Nr. 446, datë 10.5.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë vendndodhjen e terminalit të transportit publik për Bashkinë Pogradec me adresë, Rruga “Unazë”, “Zona Industriale”, Pogradec, sipas planvendosjes së Aneksit I bashkangjitur.
2. Të miratojë tarifën e operimit të terminalit të transportit publik për Bashkinë Pogradec sipas Aneksit II Bashkangjitur dhe konkretisht:

TARIFA – ORARE

- 0-5 MIN PA PAGESË
- 0-1 ORE 200 LEKË
- 1- 5 ORE 500 LEKË
- 5-24 ORE 800 LEKE TARIFA PËR ÇDO ORAR LINJE
- Mjetet 6+1 dhe 8+1 150 lek per ore

- Autobusë të transportit rrethqytetas të Bashkisë Pogradec 100 LEKË
- Autobusë të transportit rrethqytetas të Bashkive të tjera 200 LEKË
- Autobusë të transportit ndërqytetas brenda Qarkut Korçë 350 LEKË
- Autobusë të transportit ndërqytetas jashtë Qarkut Korçë 500 LEKË
- Autobusë të transportit ndërkombëtar 700 LEKË

* *Parkimi për personat me aftësi/lëvizshmëri të kufizuar është pa pagesë.*

3. Të miratojë rregulloren e funksionimit me shtojcat përkatëse me tekst sipas aneksit III bashkangjitur.
4. Administrata e Bashkisë të marrë masat për mbylljen e gjithë vëndqëndrimeve të mjeteve të transportit publik, qytetas, rrethqytetas, kombëtarë dhe ndërkombëtare në qytet.
5. Autorizohet Kryetari i Bashkisë që në zbatim të nenit 8, pikës 1 të udhëzimit nr. 446, datë 10.5.2018 “Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve,

autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve”, të lëshojë autorizimin për terminalin e transportit publik për Bashkinë Pogradec me adresën e mësipërme pasi të verifikojë plotësimin e kushteve dhe kritereve të përcaktuara në udhëzim.

6. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohen administrata dhe Kryetari i Bashkisë.

7. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.



KRYETARE
MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Pogradec, më ____ . ____ . 2024

RELACION

Në lidhje me Projekt-Vendimin "Për miratimin e vendodhjes së terminalit të transportit publik për Bashkinë Pogradec, miratimin e tarifave dhe rregullores së funksionimit".

E nderuar Kryetare e Këshillit!

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt - vendimi që paraqitet përpara jush në përgjigje të kërkesës së Subjektit "A.F.M COMPANY 88'91" Sh.p.k.", drejtuar Këshillit të Bashkisë dhe Kryetarit të Bashkisë Pogradec për miratimin e vendndodhjes së terminalit për transportin publik për Bashkinë Pogradec.

Ngritja dhe funksionimi i një terminali për transport publik është detyrim ligjor që rrjedh nga Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportin Publik", i ndryshuar dhe udhëzimin Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve". Pra, në nivel bashkie duhet të funksionojnë vendqëndrimet e pasagjerëve të transportit publik vetëm në organizim terminali. Kompetencat në legjislacionin e mësipërm janë të përcaktuara qartë, Këshilli i Bashkisë miraton vendndodhjen e terminalit, përcakton rregullat e funksionimit të terminalit për të mbrojtur interesat e qytetarëve (rregullat bazë janë të përcaktuara në Udhëzimin nr. 446, datë 10.5.2018) dhe në rastin kur terminali menaxhohet nga operatorë privatë miraton tarifën në bazë të propozimit dhe argumentimit të operatorit privat. Kryetari i Bashkisë në bazë të vendimit të Këshillit pajis me autorizim funksionimin e terminalit dhe kontrollon periodikisht plotësimin e kushteve dhe respektimin e rregullores.

Sot në qytet funksionon për linjat interurbane të Korçës dhe Tiranës, Durrësit etj, terminali i qytetit tek ish axhensia, i cili jo vetëm nuk plotëson asnjë kriter të përcaktuar nga ligji por edhe ndodhet në një pozicion në brendësi të qytetit dhe sjell shumë ngarkesë në trafikun e qytetit duke u bërë dhe problematik. Pas vënies në funksionim të terminalit, hapësira e cila sot përdoret si terminal ndërkohë që transporti për zonat rurale funksionon në pika të ndryshme në qytet çka gjithashtu është shumë problematik për shkak të trafikut dhe mungesës së sigurisë për pasagjerët dhe mjetet. Ndërsa transporti ndërkombëtar është kthyer shumë problematik pasi nuk ka një vend të përcaktuar ku të marri dhe të lerë pasagjerët që vijnë kryesisht nga Greqia. Ka qënë shqetësim dhe kërkesë e vazhdueshme e operatorëve të agjensive ndërkombëtare për të pasur një terminal për qytetin, duke qënë se autobuzët e tyre sot kalojnë vetëm në unazë, ku e kanë të pamundur të qëndrojnë qoftë edhe për disa minuta.



Bësojmë se iniciativa e operatorit "A.F.M. COMPANY 88'91" SH.P.K.", është në kohën e duhur që Pogradeci të ketë një terminal bashkëkohor në respektim të ligjit dhe standarteve të përcaktuara prej tij.

Bashkangjitur po ju paraqesim anekset e projekt - vendimit ku sqarohen:

- Vendndodhja dhe kushtet teknike-urbane të terminalit.
- Argumentimi i tarifave të propozuara.
- Rregullorja e hartuar sipas standarteve të Udhëzimit dhe përvojave më të mira.

Edhe nga ana formale mendojmë se kërkesa e paraqitur plotëson elementët e nevojshëm me informacion të mjaftueshëm për të vlerësuar plotësimin e kërkesave ligjore.

Nga ana e administratës do të verifikohet në vënd plotësimi i kriterëve të përcaktuara dhe më pas do pajiset me autorizim për funksionim nga ana e Kryetarit të Bashkisë. Gjithsesi, administrata ka detyrimin për kontroll periodik (të paktën një herë në 6 muaj) për të verifikuar respektimin e rregullave dhe kushteve të terminalit.

Nga sa më sipër mendojmë se materiali i paraqitur është i bollshëm me informacion dhe duke menduar që vënia në funksionim i terminalit bën të mundur zgjidhjen e shumë problemeve që ka sot trafiku në qytet dhe plotëson kushtet ligjore. Ngritja e një terminali nga ana e Bashkisë, jo vetëm që do kishte kosto të papërbalueshme por nga ana tjetër mendojmë se vëndodhja dhe mënyra e menaxhimit janë të përshtatshme sipas propozimit të operatorit.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar, ju ftojme në diskutim dhe votim.

Faleminderit!

Të dhënat e projekt vendimit:

Konceptoi: Erjon Vesho

Pranoi: Nexhat Shtupa

Miratoi: Besmira Niko

Konfirmoi: Paskalino Ziko



ANEKSI I

Vëndndodhja e propozuar e terminalit.

Duke konsideruar se rrugët bashkiake në brendësi të qytetit tashmë janë shumë të ngarkuara me trafik dhe terminali aktual, i cili ndodhet në vendin e quajtur ish axhensia, jo vetëm që nuk përmbush kushtet e përcaktuara nga legjislacioni por rëndon ende më tepër trafikun në qytet, në konsultim edhe me ekspertë të transportit dhe nga përvoja e vendeve të tjera, mundësi e vetme për të ngritur terminalin është në Unazën e qytetit, duke qënë se është në shtrirjen e një aksi rrugë kombëtare pa sjellë asnjë problem më mjete të transportit publik në trafikun e qytetit dhe shkurton së tepërmi distancat që duhet të përshkojnë mjetet e transportit publik sepse kanë direkt dalje në rrugë kombëtare. Nga ana tjetër, teknikisht unaza është nyja e vetme e cila përmbush kushtin e aksesit direkt në rrugë nacionale dhe njëkohësisht është pika më e afërt me qytetin.

Gjatë studimit të gjithë aksit të unazës së pogradecit, gjithnjë në konsultim edhe me ekspertët e transportit, propozohet si vëndndodhje për terminal vendi ku Unaza e qytetit bashkohet me rrugën industriale, si hapësirë e përshtatshme për funksionimin e një terminali sipas standarteve të cilat do i sqarojmë më poshtë.



Figura 1. Vëndndodhja e propozuar në lidhje me qytetin.

Kjo vëndndodhje e propozuar ka një distancë prej 1.3 km nga qendra e qytetit, pra afërsisht 3 min me makine ose 15 min në këmbë. Në këtë mënyrë është vëndndodhja më e mirë e mundshme për të siguruar plotësimin e kushteve në lidhje me distancën nga qendra dhe në lidhje me aksesin direkt në rrugë kombëtare.

Ndërkohë pozicioni është i përshtatshëm edhe për shkak të sipërfaqes në dispozicion për ngritjen e infrastrukturës së përshtatshme për terminalin.

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet tjera të terminalit të autobusëve" terminalët kategorizohen me kategori në bazë të të cilave duhet të plotësohen edhe standartet. Pavarësisht se në bazë të udhëzimit të mësipërm Pogradeci duhet të kategorizohet minimalisht me terminal të kategorisë C, për shkak të numrit të udhëtarëve të rekomanduar nga Udhëzimi i mësipërm, shtojca V, propozojmë se Pogradeci, për shkak se është qytet turistik dhe fluksi i udhëtarëve është shumë më i lartë se ai i evidentuar nga udhëzimi në atë kohë, duhet të funksionojë një terminal i kategorisë B. Këtë të drejtë Udhëzimi e le në kompetencë të Bashkisë respektive për të bërë kategorizimin.

Për këtë pikë, terminali i kategorisë B ka kriter të parë minimal sipërfaqen totale të përdorshme për instalimet, vëndqëndrimet etj, prej 901-1.500 m². (neni 3 i udhëzimit). Sipërfaqja e propozuar për funksionim është prej rreth 2.700 m².



Figure 2. Sipërfaqja e terminalit të propozuar.

Për sa i përket sipërfaqes e cila propozohet të përdoret është marrë me qera nga ana jonë për një afat 15 vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje nga pronari në plotësim të kërkesës së nenit 8, pika 4 e Udhëzimit.

Në fund të këtij anksi, po ju dorëzojmë edhe kopje të kontratës së qerasë së sipërfaqes ku propozohet të funksionojë terminali.

Projektimi i lëvizjes së mjeteve dhe udhëtareve si dhe strukturat e tjera mbështetëse të terminalit.

Dy kriteret e tjera të përcaktuara në nenin 3 të udhëzimit, për kategorinë B të terminalit janë:

-10-20 vende stacionimi autobuzësh për hipje-zbritje udhëtarësh.

- Ambjent i përshtatshëm për qëndrimin e udhëtarëve më të madh se 60 m².

Kriteret e mësipërme plotësohen nga ana jonë dhe janë pasqyruar në planimetrinë më poshtë:





Figure 3. Planimetria e funksionalitetit të terminalit.



Besojmë se planimetritë e mësipërme saktësojnë shumë elementë të tjerë në lidhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga Udhëzimi Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve". Pavarësisht se, nga ana jonë do të pasqyrohen kriteret edhe në rregulloren e terminalit në aneksin III, po sqarojmë elementët kryesore të kriterëve të kërkuara nga udhëzimi i mësipërm për funksionimin e terminalit.

Së pari, terminali do funksionojë me një hyrje dhe një dalje më vete, të zgjedhura në mënyrë të uljes së rrezikshmërisë në trafik duke parashikuar hyrjen në nyjen lidhëse të rrugës Unazë dhe rrugën Industriale, duke qënë se hyrjet e mjeteve nuk krijojnë rrezik për mjetet që qarkullojnë në të dyja krahet e rrugës, ndërsa dalja bëhet në rrugë Unazë, me fushëpamje të gjerë pa krijuar shqetësim për levizjen normale të mjeteve. Ndërkohë sigurisht që në këtë segment duhet të parashikohet lëvizja e mjeteve me shpejtësi të reduktuar duke vendosur sinjalistikën rrugore për këtë qëllim.

Ndërkohë të gjitha ambientet dhe strukturat e tjera janë të parashikuara për tu përshtatur sipas standarteve të kërkuara si, sipërfaqja e pritjes së udhëtarëve është më e madhe se 60 m², ndërkohë që së bashku me ambientet e shërbimit tejkalon disa herë këtë sipërfaqe. Terreni është i përshtatshëm për aksesim nga personat me vështirësi në lëvizje dhe personat që lëvizim me karroca. Skema e levizjes së mjeteve është e projektuar në mënyrë të tillë që mos ketë përplasje me levizjen e udhëtareve për të shmangur aksidentet. Pavarësisht kësaj sipas kërkesave të legjislacionit mjetet që bëhen gati për nisje afrohen në vendin e nisjes ku janë udhëtarët vetëm 15 minuta përpara nisjes.

Detaje të mëtejshme jemi të gatshëm ti sqarojmë nëse a paqartësi. Gjithësesi në formë më të zgjeruar do i gjeni në aneksin III ku përcaktohen rregullat e funksionimit.



ANEKSI II

Parishikimi i Tarifave.

Në zbatim të Shtojcës III të Udhëzimit nr. Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve", tarifat e aplikuar për linjat në terminale miratohen nga Këshilli Bashkiak. Në rastin ku gjendemi, ku terminali funksionon nën një autoritet përgjegjës që është kompania jonë private, tarifat miratohen sipas studimit të fizibilitetit të kompanisë.

Gjithësesi edhe në këtë rast shoqëria jonë është nisur me parimin që ndjek edhe Bashkia për vendosjen e tarifave të saj, pra me parimin e mbulimit të kostove të shërbimit.


Analiza e tarifave.

Për këtë qëllim nga ana jonë është hartuar një plan biznesi të cilin e mendojmë se është objektiv dhe shumë afër pritshmërive nga të cilat rezulton se totali i të ardhurave vjetore të parashikuara është në vlerën 60.000.000 lek/vit. Konsideruar nga ana jonë që pothuajse gjysma e të ardhurave do të jenë nga aktiviteti mbeshtetës të terminalit, si Ambjentet me qera për shoqëritë e udhëtimit, aktiviteti shitje dhe shërbime bar/kafe/restorant etj, presupozojmë që rreth 30.000.000 lek/vit të jenë të ardhurat nga tarifat e shërbimit për linjat e transportit publik dhe parkimet e mjeteve të tjera. **Bashkangjitur këtij aneksi po ju paraqesim edhe planin e biznesit të hartuar për këtë qëllim.**

Të detajuara parashikimet tona janë si më poshtë:

TABELA E TË ARDHURAVE VJETORE TË PLANIFIKUARA		
Zëri	Lek/vit	Linja/ditë
Të ardhura nga parkimi i mjeteve vetura	6 000 000	55
Të ardhura nga linjat Pogradec	1 000 000	27
Të ardhurat nga linjat Qarku Korçë	7 500 000	29
Të ardhurat nga linjat kombëtare	11 500 000	45
Të ardhurat nga linjat ndërkombetare	4 000 000	16
Total	30 000 000	

Table 1. Planifikimi i të ardhurave nga linjat e transportit publike





Tarifat e propozuara.

Nga sa më sipër për mbulimin e kostove të funksionimit si dhe mbulimin vit pas-viti të shpenzimeve të investimit, duke konsideruar dhe tarifën e terminaleve të tjerë në qytetet brenda vendit, propozojmë tarifën si më poshtë:

TARIFA – ORARE

- | | |
|---|------------------------------------|
| - 0-5 MIN | PA PAGESË |
| - 0-1 ORE | 200 LEKË |
| - 1- 5 ORE | 500 LEKË |
| - 5-24 ORE | 800 LEKË TARIFA PËR ÇDO ORAR LINJE |
| - Mjetet 6+1 dhe 8+1 | 150 lek per ore |
| - Autobuzë të transportit rrethqytetas të Bashkisë Pogradec | 100 LEKË |
| - Autobuzë të transportit rrethqytetas të Bashkive të tjera | 200 LEKË |
| - Autobuzë të transportit ndërqytetas brenda Qarkut Korçë | 350 LEKË |
| - Autobuzë të transportit ndërqytetas jashtë Qarkut Korçë | 500 LEKË |
| - Autobuzë të transportit ndërkombëtar | 700 LEKË |

* *Parkimi për personat me aftësi/lëvizshmëri të kufizuar është pa pagesë.*

Duke qënë të hapur për çdo sygjërim tuajin, jemi të gatshëm të japim çdo sqarim të mëtejshëm.

Aneksi 2.1. Plani i Biznesit.

EMRI: "A.F.M. COMPANY 88,91" SH.P.K.

NIPT: M34124601G

ADRESA: Pasuria nr 13/332, Lagjja 1,

Rruga e Vërdovës, Z. Kadastr. 8581,

Pogradec



Pogradec me 17 Prill 2024

PLAN BIZNESI

HYRJE

"A.F.M. COMPANY 88, 91" SH.P.K, me Nr. NIPT-i M34124601G per te plotesuar nevojat e tregut, ka marre me qira nje siperfaqe toke 4.773 m2 me Kontraten e qerases nr Rep. 2776 date 20.06.2023 dhe kete siperfaqe do ta shfrytetoje si aktivitet kryesor si terminal te automjeteve te transportit publik. Siperfaqja e parkimit do te jete rreth 3.500 m2.

Terminali do te funksionoj per te gjitha linjat lokale, nderqytetase apo nderkombetare. Me kete aktivitet do te arrihet pastrimi dhe lehtesimi i trafikut nga qendra e qytetit.

Ne kete siperfaqe do te ngritet nje bar restorant, guzhine, fast-food dhe piceri.

Gjithashtu ne kete siperfaqe do te kete 9 ambjente sherbimi dhe tregtie te cilat mendohet te jepen me qira. Parashikohet qe nga aktiviteti te punesohen rreth 35 punonjes.

OBJEKTIVI I PLANIT TE BIZNESIT

Domosdoshmeria dhe leverdishmeria e ketij investimi konsiston ne marrjen me qira dhe investimin ne kete siperfaqe toke (4.773 m2) si terminal te automjeteve te transportit publik.

VENDNDODHJA

Bashkangjitur ketij materiali, eshte harta treguese dhe adresa e saktuar e siperfaqes.

KOHEZGJATJA

Siperfaqja e mesiperme eshte marre me qira per nje periudhe prej 15 (pesembdhjete) vite, me te drejte riperseritje edhe per 15 (pesembdhjete) vite te tjera sipas kontrates se qirases, duke paguar qirane çdo vit sipas marrveshjes perkatese me qiradhenesin.

TREGU

Ky aktivitet, me cilesine e sherbimit qe do te ofroje, do te thithe nje sasi te caktuar klientesh, kryesisht automjetet qe do ta kene te nevojshme ndalimin aty, por gjithashtu edhe kliente private.

KLIJENTET

Si fillim nuk ka kontrata sherbimi me kliente te vecante pasi kjo eshte natyra e aktivitetit te biznesit, por parashikohen kontrata me kliente te ndryshem te Pogradecit apo qyteteve te tjera, institucione shteterore apo biznese private.

OBJEKTIVAT

Aktiviteti: Si fillim, prioritet eshte investimi per sistemimin dhe rregullimin e siperfaqes se pershkruar me siper, per te bere te mundur zhvillimin sa me mire te aktivitetit Parashikohet qe te kete rritje te volumit te shitjeve dhe rrjedhimisht te fitimit.

PASQYRA E FITIMEVE DHE HUMBJEVE



INVESTIME PARASHIKIM	LEK/VIT
PUNIME SISTEMIM, MAKINERI, PAJISJE AQT	50,000,000
INVESTIME PARASHIKIM	50,000,000
SHPENZIME PARASHIKIM	LEK/VIT
QIRA TOKE	-759,000
TAKSA DHE TARIFA VENDORE	-200,000
PAGA PUNONJESIT (35 Punonjes)	-18,000,000
SIGURIME SHOQERORE & SHENDETSORE	-5,022,000
TELEFON, ENERGJI, UJE,	-300,000
AMORTIZIM INVESTIMI	-10,000,000
KOSTO E MALLRAVE, MATERIALEVE (KMSH)	-16,000,000
SHPENZIME TE TJERA OPERATIVE	-319,000
TOTAL SHPENZIME	-50,600,000
PASQYRA E FITIMIT	VIT
TE ARDHURA NGA SHITJA	60,000,000 ¹
SHPENZIME TOTALE	-50,600,000
FITIMI BRUTO	9,400,000
TATIM FITIMI	-1,410,000
FITIMI NETO	7,990,000

ADMINISTRATORI

Olsi Qato Brancolini

¹ Në këtë vlerë përfshihen: të ardhura nga qeratë e ambjentëve (30%), të ardhura nga aktivitetet Bar kafe shitje restorant dhe shërbimet e tjera (20%) dhe tarifat e shërbimit për çdo mjet transporti publik (50%)



ANEKSI III

Rregullat e funksionimit të terminalit.

Kjo rregullore hartohet në zbatim të Udhëzimit Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifrat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve", neni 4, pika 2.

Neni 1

Operatori ose Njësia e menaxhimit të terminalit në kuptim të kësaj rregulloreje dhe në zbatim të nr. Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifrat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve" është shoqëria "A.F.M. COMPANY 88'91" SH.P.K. e regjistruar ligjërisht sipas legjislacionit shqiptar me Nipt: M34124601G

Neni 2

Qëllimi i kësaj rregulloreje është vendosja e kushteve dhe standarteve të kërkuara ligjërisht për të kryer shërbimin sa më mirë të jetë e mundur në interes të udhëtarëve dhe shoqërive të transportit publik.

Terminali do të jetë i hapur 24 orë.

Terminali do të shërbejë për të gjitha mjetet e transportit publik që veprojnë sot në qytet (6+1, 8+1, minibuzë dhe autobuzë).

Në terminal mund të ushtrohen nga Njësia e menaxhimit të terminalit ose nga palë të treta të kontraktuara nga Njësia e menaxhimit të terminalit edhe shërbime të tjera të lidhura me aktivitetin kryesor të terminalit si: sportele shërbimi, bar-kafe, restorant, shitje artikujsh për udhëtarët, shërbim hotelerie, shërbime taksit, shërbime mekanike për mjetet, furnizime me karburant ose karrikim fast charger për mjetet elektrike etj.

Aktivitetet e mësipërme nuk çenojnë funksionimin normal të terminalit duke respektuar çdo normë dhe standart të vendosur nga kjo rregullore dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 3

Terminali i udhëtarëve në Bashkinë Pogradec respekton standartet e Kategorisë B, të përcaktuara nga Udhëzimi nr. Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifrat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve".

Neni 4

Të gjithë operatorët e transportit publik, kanë kushte dhe standarte të njëjta dhe e ushtrojnë aktivitetin brenda territorit të terminalit. Për shërbimet që kryejnë në terminal do të paguajnë në kushte të njëjta sipas marrëveshjes që do lidhin me operatorin e terminalit.

Neni 5

Në ambjentet e brendshme të terminalit lejohet të operojnë vetëm automjetet e lejuara nga operatori të cilat shërbejnë për funksionimin e terminalit (si p.sh., për shërbime taksit, autoambulanca, zjarrfikëse, mjetet e policisë së shtetit, mjetet e sigurimit të objektit, mjete të serviseve etj.). Të gjitha automjetet e tjera të udhëtarëve, të punonjësve të terminalit dhe të personave të tjerë, nuk duhet të lëvizin brenda territorit të tij. Shërbimet që nevojiten për mirëmbajtjen e autobusëve, si edhe furnizimit të tyre me karburant, janë të vendosura në një hapësirë të përcaktuar të terminalit pa penguar funksionimin normal



të ambienteve, të cilat janë të destinuara për qëndrimin dhe lëvizjen e mjeteve dhe të udhëtarëve në terminal. Distanca midis zonës së qëndrimit të udhëtarëve me vendqëndrimin (platformën) e autobusëve, nuk është më e vogël se 6 m.

Neni 6 Kushtet teknike

Terminali ka në funksion vazhdimisht, tabelën e cila ka mbishkrimin "Terminali i Autobuzëve Bashkia Pogradec" dhe hartën e territorit administrativ. Hyrja dhe dalja më vete e terminalit do të jetë gjithnjë e lirë për ti shërbyer funksionimit normal.

Në krahun e djathtë të hyrjes së terminalit do jetë vendqëndrimi i mjeteve taksi dhe transportit publik qytetas si dhe mjetet e tjera për tu aksesuar nga udhëtarët.

Në terminal do të funksionojë 24 orë sistemi i kamerave të sigurisë, me server ku do jenë në regjistrim të paktën 48 orë nga cdo kamerë.

Terminali është i pajisur me dalje emergjence.

Neni 7

Skema e qarkullimit të mjeteve dhe udhëtarëve është sipas planimetrisë bashkangjitur duke krijuar siguri për jetën dhe shëndetin e udhëtarëve. Gjithë infrastruktura do të jetë aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara; Në terren ka sinjalistikë të dukshme për:

- Hapësirë shesh qëndrimi për autobusët që janë në pritje;
- Parkim automjeteve pranë terminalit, për shërbimin "Park and Go";
- Zonë të caktuar pranë terminalit për shërbimet e transportit qytetas, rrethqytetas, taksi dhe biçikleta me qira, si dhe për shërbimet e transportit "Kiss and Ride";
- Ndriçim elektrik ose me energji alternative (diellore) brenda dhe jashtë ndërtesës së terminalit të autobusëve;
- Poste karikimi *fast charger* për automjetet elektrike.
- Hapësirë të mjaftueshme për lëvizjen e autobusëve të pajisur me sinjalistikë vertikale dhe horizontale;
- Tabelë të lexueshme (elektronike) për oraret e udhëtimit, numrin e vendqëndrimit (platformës) në disa pika të terminalit të autobusëve;
- Një pikë informuese e pajisur me pajisje të njoftimit zanor, për informimin e udhëtarëve mbi oraret e nisjeve dhe destinacionet;
- Zyrë informacioni për udhëtarët;
- Sportele për shitje të biletave;
- Sallë pritje për udhëtarët.
- Tualete për meshkuj dhe femra dhe personat me aftësi të kufizuara.
- Një dhomë e ndarë për nënat me fëmijë, me tualet dhe lavaman.
- Dhoma të sigurtë për pranimin dhe dorëzimin e bagazheve apo ruajtjen e tyre.
- Ora për matjen/tregimin e kohës;
- Ambiente të dedikuara për personelin që shërben në terminal;
- Shërbim interneti (Wi-Fi) pa pagesë në gjithë zonën/territorin e terminalit
- *Terminali më vonë mund të ofrojë edhe shërbime hotelerie dhe/ose njësi shërbimi për udhëtarët.*



Neni 8

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe të shërbimeve për transportues dhe udhëtarët, terminali i autobusëve do t'i përmbahet kohës së qëndrimit të transportuesit në vendnisjet dhe vendmbërritjet, si më poshtë:

- Koha e hyrjes në vendnisjen për transportues në transportin ndërqytetës është 15 minuta para nisjes;
- Koha e hyrjes në vendnisjen për transportues në transportin ndërkombëtar është 30 minuta para nisjes;
- Koha e hyrjes në vendnisjen për transportues që shfrytëzojnë terminalin si transit është 15 minuta para nisjes.

Lartësia e lirë për transitin e autobusëve nën trarët, portat hyrëse, fiksuesit e tabelave vezulluese, etj. duhet të jetë të paktën 5 m.

Sistemi i instalimeve elektrike, duhet të sigurojë ndriçim uniform në zonë dhe gradualisht të ambientueshëm me nivelin e ndriçimit nga zona në zonë

Neni 9

Operatori do t'i përmbahet kushteve të legjislacionit në fuqi duke kryer raportim 3 (tre) mujor në Ministri dhe Strukturën e transportit në Bashki për numrin e hyrje daljeve të autobuzeve si dhe të dhëna të tjera të kërkuara nga insitucionet.

Operatori i nënshtrohet kontrollit minimalisht 6 (gjashtë) mujor të ushtruar nga personi i përcaktuar nga Bashkia mbi respektimin e kushteve të funksionimit të terminalit.

Operatori/Njësia e menaxhimit të terminalit, siguron kushtet për nisjen dhe mbërritjen e autobuzeve të transportit publik vetëm sipas orareve të miratuara nga insitucionet përkatëse. Për këtë qëllim çdo agjensi apo operator i transportit publik është i detyruar që në momentin e bërjes së marrëveshjes për shërbimet që ofron terminali të verë në dispozicion të Njesisë së menaxhimit të terminalit dokumentacionin provues të orareve të miratuara nga organet përkatëse.

Neni 10

Njësia menaxhimit të terminalit, do të krijojë, përditësojë dhe mirëmbajë në mënyrë elektronike regjistrin e të dhënave, ku përfshihen:

- a) Emrat e subjekteve transportuese që operojnë në terminal;
- b) Emërtimin e linjës (O/D), me stacionet e ndërmjetme dhe gjatësinë e linjës;
- c) Oraret dhe frekuencat;
- d) Numrin e autobusëve në punë, vitin e prodhimit dhe targat e autobusëve;
- e) Numrin e udhëtarëve që udhëtojnë.

Neni 11

Në bashkëpunim me organizatat përfaqësuese të personave të paafte ose personave me lëvizshmëri të kufizuar, transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, aty ku është e përshtatshme nëpërmjet organizatave të tyre, do të krijojnë ose i kanë krijuar, kushte jodiskriminuese hyrje për transportin e personave të paafte ose personat me lëvizshmëri të kufizuar.



Operatori do të japë informacion mbi oraret e nisjes dhe mbëritjes së autobusëve si dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për udhëtarët nëpërmjet afishimit në ambientet e terminalit si dhe nëpërmjet internetit.

Neni 12

Njësia e menaxhimit të terminalit në bashkëpunim me operatorët e shërbimit të transportit publik, ofron kushtet e nevojshme për personat me aftësi ndryshe, pa pagesë sipas përcaktimeve të nenit 13-17 të Udhëzimit nr. Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve".

Neni 13

1. Në rast të anulimit ose të vonesës në nisjen e një shërbimi të rregullt, udhëtarët që nisen nga terminali do të informohen nga transportuesi ose, kur është e përshtatshme, nga njësia e menaxhimit të terminalit, të situatës së krijuar sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 30 minuta pas kohës së planifikuar të nisjes dhe të kohës së vlerësuar të nisjes, duhet që sa më shpejt ky informacion të jetë në dispozicion.
2. Në qoftë se udhëtarët humbasin, sipas rendit të udhëtimit, një shërbim që nis për shkak të një anulimi apo vonese, transportuesit ose, kur është e përshtatshme, njësia e menaxhimit të terminalit, do të bëjë përpjekje të arsyeshme për të informuar udhëtarët në fjalë në lidhje me alternativat.
3. Transportuesit ose, sipas rastit, njësia e menaxhimit të terminalit, do të sigurojnë që personat e paafte ose personat me lëvizshmëri të kufizuar të marrin informacionin e kërkuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 në formate të mundshme për t'u përdorur.
4. Kur është e mundur, informacioni i kërkuar sipas paragrafëve 1 dhe 2 do të sigurohet me mjete elektronike për të gjithë udhëtarët, duke përfshirë edhe ato që nisen nga stacionet e autobusëve, brenda afatit të përcaktuar në paragrafin 1, nëse udhëtari e ka kërkuar këtë dhe janë kusht që detajet e nevojshme të kontaktit t'i jepen transportuesit.
5. Transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, brenda zonave të tyre përkatëse të përgjegjësisë, u sigurojnë udhëtarëve informacion të përshtatshëm gjatë gjithë udhëtimit të tyre. Kur është e mundur, ky informacion do t'i sigurohet në formate të mundshme për t'u përdorur, sipas kërkesës.

Neni 14

Informacioni mbi të drejtat e udhëtarëve.

1. Transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit, brenda zonave/territorit të tyre përkatës të përgjegjësisë, sigurojnë që udhëtarë të jenë të pajisur me informacionin e duhur dhe të kuptueshëm në lidhje me të drejtat e tyre, sipas rregullores së brendshme të funksionimit të terminalit, për vonesën në nisje. Ky informacion duhet të sigurohet në terminale dhe kur është e aplikueshme, në internet. Me kërkesë të një personi të paafte ose personi me lëvizshmëri të kufizuar, informacioni do t'i ofrohet, kur është e mundur, në një format të përshtatshëm. Ky informacion do të përfshijë detajet e kontaktit të organit të zbatimit apo të organeve të caktuara nga autoriteti kompetent.



2. Me qëllim plotësimin e informacionit të kërkuar në paragrafin 1, transportuesit dhe njësia e menaxhimit të terminalit mund të përdorin një përmbledhje të dispozitave të këtij udhëzimi në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze dhe të bëjnë të vlefshme për të interesuarit.

Neni 15

Njësia e menaxhimit të terminalit do të lidhë marrëveshje me agjensitë dhe pronarët e mjeteve të transportit publik, ku do të parashikojnë përveç shërbimeve që do ju ofrojë terminali, pagesat për këto shërbime edhe dispozitat e kësaj rregulloreje për të qënë të detyrueshme edhe për agjensitë/pronaret e mjeteve të transportit publik.

Mosrespektimi i dispozitave të kësaj rregulloreje dhe legjislacionit në lidhje me të drejtat e udhëtarëve do të ketë sanksione për transportuesit sipas shkallës së tyre të fajit.

**Neni 16
Tarifat**

Terminali do të aplikojë për çdo mjet transporti publik tarifat si më poshtë:

TARIFA – ORARE

- 0-5 MIN PA PAGESË
- 0-1 ORE 200 LEKË
- 1- 5 ORE 500 LEKË
- 5-24 ORE 800 LEKE TARIFA PËR ÇDO ORAR LINJE
- Mjetet 6+1 dhe 8+1 150 lek per ore

- Autobuzë të transportit rrethqytetas të Bashkisë Pogradec 100 LEKË
- Autobuzë të transportit rrethqytetas të Bashkive të tjera 200 LEKË
- Autobuzë të transportit ndërqytetas brenda Qarkut Korçë 350 LEKË
- Autobuzë të transportit ndërqytetas jashtë Qarkut Korçë 500 LEKË
- Autobuzë të transportit ndërkombëtar 700 LEKË

* *Parkimi për personat me aftësi/lëvizshmëri të kufizuar është pa pagesë.*

Tarifa për marrje në ruajtje të bagazheve për tu dërguar në destinacion ose të erdhura nga vendet e tjera është 300 lek për bagazhet deri në 10 kg. Për bagazhe me peshë më të madhe do aplikohet tarifë e diferencuar në varësi të peshës dhe madhësisë.

Terminali do të ketë tarifa të përcaktuara në marrëveshje me palët për ambiente me qera për shoqëritë e udhëtimit, kostot e sportelit të biletave dhe shërbime të kërkuara nga transportuesit.

Neni 17

Dispozitat e fundit.

Për çdo interpretim apo mangësi në parashikimin e rasteve të kësaj rregulloreje, do të zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe sidomos Udhëzimi nr. Nr. 446, datë 10.5.2018 "Për kategorizimin, kushtet që duhet të plotësojë terminali i autobusëve, autorizimi, mënyra e mbajtjes së dokumentacionit, tarifat dhe detyrimet e tjera të terminalit të autobusëve" dhe Kodi Civil.

Kjo rregullore është publike.

Shtojca e rregullore së terminalit të autobusave të transportit të udhetarëve për linjat nderqytetëse, rrethqytetëse, qytetëse dhe nderkombetare për Bashkinë Pogradec, e zbatueshme për të gjithë përdoruesit.



(Për marrëdhëniet e shoqërive të transportit dhe përdoruesve të mjeteve brenda në terminal)

Miratuar me Vendim të këshillit të Bashkisë Pogradec nr. _____, datë ____/____/2024.

1. Terminali mundeson stacionimin e linjave të Autobuzave për linjat Nderqytetëse rrethqytetëse, qytetëse dhe nderkombetare për Bashkinë Pogradec.
2. Hyrja e mjeteve në Terminal bëhet vetëm për mjetet motorike, të cilat janë të pajisura me leje transporti dhe licencim, të vlefshme, për linën perkatese nderqytetëse dhe rrethqytetëse me orare të percaktuara.
3. Tarifat e Stacionimit në Terminal janë të miratuara sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Pogradec Nr. _____, datë ____/____/2024, për "Caktimin e tarifave të parkimit
4. Perfaqesuesit e linjave perkatese duhet të pajisen me kuponin tatimor në momentin e daljes nga Terminali.
5. Perfaqesuesit e linjave perkatese Nderqytetëse/Rrethqytetëse duhet të respektojnë sinjalistikën e zonës së stacionimit në mënyrë që të mos shkaktojnë pengesa apo vështirësi për perfaqesuesit e tjera të linjave nderqytetëse. Në raste të shkeljes së rregullores së Terminalit, duhet të lajmerone Perfaqesuesin e Terminalit për zgjidhjen e problemit konform rregullores.
6. Perfaqesuesi i Linjes perkatese Nderqytetëse/Rrethqytetëse është në dijeni se Terminali nuk do të mbaje asnjë përgjegësi ligjore për dëmtime direkte apo indirekte të shkaktuara nga palët e tjera apo vete përdoruesit e tjera të Terminalit si vjedhje, tentativa për vjedhje të sendeve, objekteve, materialeve të ndodhura brenda apo në bagazhe të mjeteve motorike.
7. Terminali nuk është përgjegës për demet që mund të shkaktohet nga nga të tretet brenda në Terminal.
8. Automjetet gjatë daljes nga Terminali, duhet të respektojnë rregullat e qarkullimit dhe të levizjes (të jenë me dyer dhe bagazh të mbyllur).
9. Në rastet kur Perfaqesuesit e linjes Nderqytetëse/Rrethqytetëse shkaktojnë dëmtime të Terminalit, me ose pa dashje, atëherë ky i fundit duhet të demshperblejë Terminalin me vlerën e plot financiare të dëmit të shkaktuar.
10. Në rastet e mosrespektimit të rregullores së Terminalit nga Perfaqesuesit e Linjave Nderqytetëse/Rrethqytetëse, Autoriteti që administron Terminalin do të marrë masa administrative deri në moslejimin e futjes së autobuzëve brenda Terminalit.

Kujdes!

Ndalohet lenia e mjetit motorik ndezur brenda Terminalit.

Ndalohet hyrja/dalja nga Terminali e mjetit me shpejtësi përtej normave të lejuara në Kodin Rugor të Republikës Shqiptare.

Ndalohet pirja e duhanit në vendin e percaktuar si stacionim apo në zonë të tjera.

Ndalohet mjeti motorik të blokojë apo pengojë levizjet e mjeteve të tjera brenda Terminalit.

Ndalohet mbajtja e lëndës djegëse apo mjeteve ndezëse në Terminal.



Ndalohet të transportoje, furnizojë apo boshatisë depozitën e mjetit motorik me karburant brenda Terminalit.

Ndalohet të qëndrojë brenda Terminalit pasi ka kryer pagesën për dalje nga Terminali.

Ndalohet të hyjë në Terminal me mjetin e tij, i cili është duke rjedhur ose pikuar karburant apo vajra.

Ndalohet të hedhë plehera apo lloje mbetje në zonën e Terminalit, përveçse në vende të përcaktuara për këtë qëllim.

Ndalohet të hedhë apo të shkaktojë derdhje të mbetjeve të rrezikshme në zonën e Terminalit apo në pajisje të lidhura me të.

Ndalohet të kryejë çdo shërbim mirembajtjeje apo riparim të mjetit motorik në Zonën e Terminalit, përveç rasteve kur i aprovohet leja për këtë, nga Përfaqësuesi i Terminalit.

Çdo ankese nga përdoruesit e Terminalit në lidhje me menaxhimin, stacionimin, funksionimin, dhe seljen e stafit të Terminalit duhet të adresohet në mënyrë të shkruar pranë administratës së Terminalit.

Keto rregulla dhe rregullat që miratohen në vazhdimësi nga ne janë të detyrueshme për zbatim nga të gjithë përdoruesit e Terminalit.

Për një organizim dhe funksionim sa më të mirë të punës si dhe për të mos patur abuzime në konkurrencë, subjekteve që operojnë në terminal u kërkohet venia në dispozicion të dokumentacionit përkatës (të noterizuar), konkretisht:

- Liçensa/Autorizim e subjektit për të kryer transport udhëtarësh në linjë të rregullt.
- Çertifikatat/Lejet e qarkullimit të mjeteve që janë të autorizuar për të kryer këtë shërbim.

Licenca përmban:

- Emrin e subjektit/selia/numër Nipt
- Linja/Itinerari/Oraret e nisjes dhe të kthimit
- Data e lëshimit të licenses
- Vlefshmëria

Çertifikata e mjetit përmban:

1. Të dhënat e mjetit:
 - a. Targa
 - b. Tipi
2. Të dhënat e licenses:
 - a. Emri i subjektit
 - b. Numër Nipt
3. Linja:
 - a. Itinerari
 - b. Vlefshmëria e gertefikates

Në terminal duhet të ketë të afishuar oraret e linjave të cilat janë në ndihmë të udhëtarëve.